



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË

Nr. 1343 Prot.

Tiranë, më 12 . 04 , 2025

Lënda: Përgjigje ndaj kërkesës për njohjen e certifikatave të kalibrimit të radarëve të lëshuara nga laboratorit

Në vijim të kërkesave tuaja të protokolluara në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë me nr. 649/2, datë 28.04.2025 dhe nr. 649/3, datë 14.05.2025, që lidhen me njohjen e certifikatave të kalibrimit për pajisjet matëse të tipit "SMART + SPEED 85", ju informojmë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik të depozituar dhe verifikimit të plotë të të dhënave të kalibrimit, rezulton se:

- Laboratori i cili ka kryer shërbimin e kalibrimit për pajisjet e përmendura, është i akredituar nga organi kombëtar i akreditimit të Italisë (ACCREDIA), i cili është anëtar me të drejta të plota i organizatës europiane për bashkëpunimin në fushën e akreditimit (EA – European co-operation for Accreditation).
- Certifikatat e kalibrimit janë lëshuar për instrumente specifike dhe janë të mbështetura në standardin ndërkombëtar ISO/IEC 17025:2017, në përputhje me praktikën e njohjes së ndërsjellë të rezultateve të kalibrimit nga laboratorë të akredituar sipas këtij standardi.
- Për modelet specifike të radarëve të instaluar është dokumentuar saktësisht përkatësia me fushën e akreditimit të laboratorit në fjalë.

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë, në përmbushje të detyrimeve të saj ligjore parashikuar në ligjin nr. 126/2020 "Për Metrologjinë", si dhe në mungesë të kapaciteteve të brendshme për kalibrimin specifik të këtyre pajisjeve, njeh certifikatat e lëshuara nga laboratorit i akredituar vetëm për qëllime vlerësimi teknik dhe përdorimi operacional të instrumenteve në fjalë, brenda kuadrit të kontrollit metrologjik.

Kjo njohje nuk përbën proces verifikimi metrologjik sipas legjislacionit shqiptar, si dhe nuk zëvendëson detyrimet përkatëse që lidhen me miratimin e tipit, verifikimin fillestar dhe/ose periodik të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Alkida Lala

